Nr. 404/6 prot. Tiranë, më 28.10.2024

| | |
|---|---|
| **Lënda:** | Ankim i Komisionerit Publik kundër vendimit nr. 802, të datës 23.9.2024, të Komisionit të Pavarur të Kualifikimit, për subjektin e rivlerësimit, znj. Flora Çela |
| **Baza ligjore:** | Neni 179/b, pika 5 e Kushtetutës, neni C, pika 2, neni F i aneksit të Kushtetutës, neni 63 i ligjit nr. 84/2016, "Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë" |
| **Për kompetencë:** | Kolegjit të Posaçëm të Apelimit, pranë Gjykatës Kushtetuese |
| **Për dijeni:** | Operacionit Ndërkombëtar të Monitorimit (ONM) |
| **Depozituar pranë:** | Komisionit të Pavarur të Kualifikimit |

Të nderuar zonja/zotërinj, gjyqtarë të Kolegjit të Posaçëm të Apelimit, pranë Gjykatës Kushtetuese,

Në zbatim të nenit 55, pika 7 e ligjit nr. 84/2016, "Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në RSH", pranë Institucionit të Komisionerëve Publikë, më datë 14.10.2024, është njoftuar *vendimi nr.802, datë 23.9.2024,* i Komisionit të Pavarur të Kualifikimit, *për konfirmimin në detyrë të subjektit të rivlerësimit, znj. Flora Çela*, prokurore në Prokurorinë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm, Vlorë.

Ndaj këtij vendimi, bazuar në nenin B, pika 3, germa "c", të aneksit të Kushtetutës, pranë Institucionit të Komisionerëve Publikë, më datë 16.10.2024, është depozituar akti: "Rekomandim për paraqitje ankimi", nr. 338/1 prot., datë 16.10.2024[1], nënshkruar nga një komision prej tre vëzhguesish ndërkombëtarë të Operacionit Ndërkombëtar të Monitorimit.

Komisioneri Publik, në mbështetje të nenit C, pika 2, si përfaqësues i interesit publik, nenit F i aneksit të Kushtetutës dhe nenit 63, pika 1 e ligjit nr. 84/2016, ka të drejtë të ankimojë vendimin brenda afatit 15-ditor nga njoftimi.

[1] Protokolluar pranë IKP-së me nr. 404/2 prot., datë 16.10.2024.

Brenda afatit ligjor, Komisioneri Publik ushtron ankim ndaj vendimit nr. 802, të datës 23.9.2024, të Komisionit të Pavarur të Kualifikimit.

## I. Procesi i rivlerësimit dhe përfundimet e Komisionit të Pavarur të Kualifikimit

1. Subjekti i rivlerësimit, znj. Flora Çela, me detyrë prokurore në Prokurorinë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm, Vlorë, i është nënshtruar rivlerësimit *ex officio,* në bazë të pikës 3, të nenit 179/b, të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë.

2. Për këtë qëllim, Komisioni i Pavarur i Kualifikimit (*në vijim referuar si Komisioni*) ka administruar raportet e vlerësimit të hartuara për këtë subjekt nga institucionet ndihmëse, si Inspektorati i Lartë i Deklarimit dhe Kontrollit të Pasurive dhe Konfliktit të Interesave (në vijim referuar si ILDKPKI), Raportin e vlerësimit të figurës nga Drejtoria e Sigurimit të Informacionit të Klasifikuar (në vijim referuar si AKSIK) dhe Raportin e vlerësimit profesional nga Këshilli i Lartë i Prokurorisë (në vijim referuar si KLP), nga të cilat rezulton se:

2.1 **ILDKPKI**, bazuar në nenin 33, pika 5 e ligjit nr. 84/2016, me anë të *"Aktit të përfundimit të kontrollit të plotë të deklaratës së pasurisë për subjektin Flora Çela[2]"*, ka referuar për subjektin, se:

*i. deklarimi nuk është i saktë në përputhje me ligjin;*

*ii. ka mungesë dokumentacioni ligjor për të justifikuar pasuritë;*

*iii. nuk ka kryer fshehje të pasurisë ndër vite;*

*iv. nuk ka kryer deklarim të rremë;*

*v. subjekti nuk gjendet në situatën e konfliktit të interesave.*

2.2 **AKSIK,** bazuar në nenin 39, pika 2, të ligjit nr. 84/2016, me anë të Raportit mbi kontrollin e figurës për subjektin e rivlerësimit, i ka referuar Komisionit: *"Përshtatshmërinë për vazhdimin e detyrës".* Më tej, pas kërkesës së Komisionit[3] për përditësimin e informacioneve, AKSIK ka dërguar raportin nr. *** prot., datë **.7.2023, deklasifikuar pjesërisht me Vendimin e KDZH-së nr. ***, datë **.7.2023. Informacionet në raportin e përditësuar bëjnë me dije se: […] *Për subjektin e rivlerësimit, znj. Flora *** Çela, disponohet një indikacion ...ku supozohet përfshirja e saj në veprimtari të kundërligjshme* […]. Në vlerësim të të dhënave që disponohen për subjektin e rivlerësimit rezulton se: *në konfirmim të konstatimit fillestar për përshtatshmëri në vijimin e ushtrimit të detyrës për subjektin e rivlerësimit Flora *** Çela gjykojmë që për rastin në fjalë konkluzioni të mbetet në vlerësimin tuaj, nën dritën e informacioneve të tjera që mund të dispononi si pjesë e gjetjeve/konstatimeve të dala nga procedurat e hetimit administrativ që po kryhen ndaj subjektit të rivlerësimit.*

[2] Raporti me nr. ***/** prot., datë **.3.2018, i ILDKPKI-së.
[3] Me shkresën nr. *** prot, datë **.7.2023, administruar në dosjen e Komisionit.

2.3 **KLP**, bazuar në nenin 43, pika 2 e ligjit nr. 84/2016, në përfundim të rishikimit të dokumenteve ligjore të përpiluara nga subjekti gjatë periudhës objekt rivlerësimi, ka përcjellë pranë Komisionit raportin për analizimin e aftësisë profesionale të subjektit, znj. Flora Çela[4].

3. Komisioni, pasi shqyrtoi kriteret e vlerësimit të aftësive profesionale sipas përcaktimeve të nenit E, pika 2 e aneksit të Kushtetutës, ka vlerësuar se subjekti i rivlerësimit:

*(1) Ka mangësi në aftësinë për të hetuar, duke mos ndërmarrë logjikisht hetimin sipas kërkesave ligjore, duke mos mbledhur provat e kërkuara me ligj, duke mos interpretuar ligjin, në pikën 2, të nenit 73, të ligjit nr. 96/2016, "Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë", i ndryshuar. Kjo mangësi në rastet e analizuara në vlerësimin e trupit gjykues është e lidhur kryesisht me: (i) moskryerjen e hetimeve nga subjekti në drejtim të verifikimit të çdo dyshimi të lindur gjatë procesit hetimor, pavarësisht rezultatit përfundimtar; (ii) vlerësimin nga subjekti të rrethanave në drejtim të kualifikimit të një vepre tjetër penale, kur nga faktet rezultojnë të dhëna të tilla. Në këtë drejtim, trupi gjykues, pavarësisht bindjes së subjektit, ndalimit të Komisionit për të çmuar korrektësinë e themelit, vlerëson se mangësitë janë të tilla që mund të plotësohen duke ndjekur programin e trajnimit pranë Shkollës së Magjistraturës.*

*(2) Ka mangësi në aspektin e administrimit të akteve dhe mbikëqyrjen e plotësisë së tyre dhe respektimit të afateve.*

*(3) Shfaq mangësi në drejtim të prezencës së saj në ndjekjen e procedurave gjyqësore brenda kritereve dhe afateve të nevojshme për kryerjen e një procesi të rregullt gjyqësor.*

3.1 Për këto arsye, Komisioni, sipas përcaktimeve të nenit 44, shkronja "b" e ligjit nr. 84/2016, ka vlerësuar se subjekti i rivlerësimit konsiderohet *"Me mangësi",* të cilat mund të plotësohen duke ndjekur programin e trajnimit pranë Shkollës së Magjistraturës brenda 1 viti dhe, në bazë të shkronjës "b", të pikës 1, të nenit 58, nenit 44/b, si dhe të pikës 1, të nenit 60, të ligjit nr. 84/2016, me vendim të ndërmjetëm nr. 4, datë 17.10.2023, publikuar në faqen zyrtare të Komisionit[5], ka vendosur: "*Pezullimin nga detyra për një periudhë 1-vjeçare të subjektit të rivlerësimit, znj. Flora Çela, dhe detyrimin e saj për të ndjekur programin e trajnimit, sipas kurikulave të miratuara nga Shkolla e Magjistraturës*".

3.2 Shkolla e Magjistraturës, me shkresën nr. *** prot., datë **.8.2024, ka dërguar pranë Komisionit rezultatet e provimit përfundimtar të subjektit, bazuar në pikën 2, të nenit 60, të ligjit nr. 84/2016, të miratuara nga Këshilli Pedagogjik, si dhe Këshilli Drejtues i Shkollës së Magjistraturës, me vendimin nr. **, datë **.7.2024.

3.3 Pas administrimit të këtyre rezultateve, trupi gjykues i mbledhur në dhomë këshillimi, me vendimin nr. 5, në datën 16.9.2024 diskutoi, vlerësoi dhe vendosi të konsiderojë të përfunduar procesin e rivlerësimit për subjektin e rivlerësimit znj. Flora Çela, mbi të njëjtat rezultate hetimi, duke vijuar me njoftimin e saj në seancë dëgjimore për shpalljen e vendimit përfundimtar.

---

[4] Nr.*** prot., datë **.5.2023.
[5] https://kpk.al/wp-content/uploads/2023/11/Vendim-per-pezullim-Flora-Cela-anonimizuar.pdf

4. Përfundimet e Komisionit për secilin kriter kontrolli, në mënyrë të përmbledhur, janë si vijon:

4.1 ***Për vlerësimin e pasurisë.*** *[...] Në përfundim, lidhur me hetimin e kryer për kontrollin e kriterit të pasurisë, bazuar në konkluzionet më lart, për të gjitha pasuritë e deklaruara të subjektit të rivlerësimit dhe personave të lidhur me të, trupi gjykues në vlerësimin tërësor arrin në konkluzionin se subjekti i rivlerësimit, znj. Flora Çela, ka arritur nivel të besueshëm për këtë kriter, sipas shkronjës "a", të pikës 1, të nenit 59, të ligjit nr. 84/2016 [...].*

4.2 ***Për kontrollin e figurës.*** *[...] Në përfundim, në lidhje me kontrollin e figurës, trupi gjykues, për sa kohë nga hetimi nuk evidentoi ndonjë fakt apo provë që mund të passillte cenimin e figurës së subjektit, arrin në përfundimin se subjekti i rivlerësimit ka arritur nivel të besueshëm në kontrollin e figurës sipas parashikimit të shkronjës "b", të nenit 59/1, të ligjit nr. 84/2016 [...].*

4.3 ***Për vlerësimin e aftësive profesionale.*** *[...] Në përfundim, lidhur me vlerësimin e kriterit profesional, trupi gjykues i Komisionit, pasi: (i) administroi vlerësimin e ardhur nga Shkolla e Magjistraturës, e cila ka konkluduar se subjekti i rivlerësimit ka kaluar mangësitë e parashtruara në vendimin e ndërmjetëm të Komisionit; (ii) shqyrtoi në tërësi kriterin e vlerësimit të aftësive profesionale, sipas parashikimit të pikës 2, të nenit E, të aneksit të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë – arrin në konkluzionin se subjekti i rivlerësimit ka arritur nivel kualifikues në vlerësimin e aftësive profesionale, në përmbushje të parashikimit të shkronjës "a", të nenit 44, të ligjit nr. 84/2016 [...].*

5. **Vendimi i Komisionit.** Nisur nga përfundimet e mësipërme, për secilin kriter kontrolli, Komisioni, bazuar në pikën 5, të nenit 55, të ligjit nr. 84/2016, pasi u mblodh në dhomë këshillimi, në prani edhe të vëzhguesit ndërkombëtar, referuar nenit 4, pika 2, nenit 58, pika 1, shkronja "a", si dhe nenit 59, pika 1 e ligjit nr. 84/2016, "Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë", arriti në përfundimin se subjekti i rivlerësimit, znj. Flora Çela: *(a) ka arritur nivel të besueshëm në vlerësimin e pasurisë; (b) ka arritur nivel të besueshëm në kontrollin e figurës; (c) ka arritur nivel kualifikues në vlerësimin e aftësive profesionale*, ka vendosur:

1. *Konfirmimin në detyrë të subjektit të rivlerësimit, znj. Flora Çela, prokurore në Prokurorinë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm, Vlorë.*

## II. Rekomandimi i Operacionit Ndërkombëtar të Monitorimit (ONM)

6. Vëzhguesit ndërkombëtarë, nëpërmjet aktit "Rekomandim për paraqitje ankimi", ndër të tjera, referojnë se në momentin e hetimit administrativ dhe vendimmarrjes nga Komisioni të vendimit të ndërmjetëm *nr. 4, datë 17.10.2023*, për "Pezullimin nga detyra për një periudhë 1-vjeçare të subjektit të rivlerësimit, znj. Flora Çela, dhe detyrimin e saj për të ndjekur programin e trajnimit, sipas kurikulave të miratuara nga Shkolla e Magjistraturës", Komisioni kishte të administruar vetëm një kopje të pjesshme të dosjes që lidhej me lajmin e publikuar në median e shkruar[6], rast për të cilën subjektit të rivlerësimit Komisioni i ka kërkuar të japë shpjegime të detajuara.

[6] https://***.**/u-kapen-20-tone-kanabis-ne-vlore-prokuroria-urdheron-lirimin-e-pronareve-te-droges.

6.1 Vëzhguesi ndërkombëtar, që po ndiqte rastin, kërkoi më pas një kopje zyrtare të dosjes nga Prokuroria pranë/dhe Gjykata e Shkallës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Vlorë. Dokumentacioni i dosjes u administrua nga ONM, më datë *12 janar 2024*. Vëzhguesi Ndërkombëtar në vlerësim të rishikimit të dosjes së plotë të administruar, rezultateve të seancës dëgjimore dhe dy vendimeve të Komisionit, vlerëson se provat e administruara gjatë hetimit, justifikojnë shqyrtimin e rastit nga Kolegji i Posaçëm i Apelimit. Konkretisht, vëzhguesit ndërkombëtarë që kanë nënshkruar Rekomandimin, çmojnë se vendimi i Komisionit për të konfirmuar në detyrë subjektin e rivlerësimit, znj. Çela, është i pajustifikuar, për shkak të shumë mangësive profesionale të treguara nga subjekti i rivlerësimit.

6.2 Vëzhguesit ndërkombëtarë çmojnë se, në rivlerësim të gjetjeve të rastit, veprimet e subjektit të rivlerësimit, tregojnë sjellje dhe mangësi profesionale, që bëjnë që subjekti i rivlerësimit të jetë i papërshtatshëm për ushtrimin e detyrës dhe çojnë në aplikimin e nenit 61, pika 4 dhe 5 e ligjit nr. 84/2016.

## III. Vlerësimi i Komisionerit Publik

7. Në kuptim të nenit 179/b të Kushtetutës, aneksit të Kushtetutës dhe ligjit nr. 84/2016, "Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë", Komisioneri Publik është një nga tri institucionet e ngarkuara për kryerjen e procesit të rivlerësimit kalimtar (Vetting). Bazuar në këto parashikime kushtetuese dhe ligjore, Komisionerit Publik, si përfaqësues i interesit publik në kryerjen e këtij procesi, i njihet e drejta e ankimit kundër vendimeve të Komisionit dhe paraqitjen e tyre juridiksionit rivlerësues të Kolegjit të Posaçëm të Apelimit (në vijim referuar si Kolegji).

8. Në krahasim me kompetencat e njohura Komisionit dhe Kolegjit, nga neni Ç i aneksit të Kushtetutës dhe nenet 48-52 të ligjit nr. 84/2016, Komisioneri Publik është i detyruar që kompetencën e tij për të ushtruar ankim ndaj vendimeve të Komisionit, ta mbështesë vetëm në aktet dhe provat e administruara gjatë kryerjes së procesit të rivlerësimit nga ana e Komisionit, në momentin procedural të njoftimit të vendimit të Komisionit, sipas nenit 63, pika 1 e ligjit nr. 84/2016.

9. Nga burime të hapura informacioni, rezulton se Komisioni, *vendimin e ndërmjetëm nr.4 datë 17.10.2023*, përmes të cilit ka vendosur *"Pezullimin nga detyra i znj. Flora Çela, për një periudhë njëvjeçare dhe detyrimin për të ndjekur programin e trajnimit, sipas kurikulave të miratuara nga Shkolla e Magjistraturës",* e ka publikuar të anonimizuar në faqen zyrtare të Komisionit më datë 23.11.2023, dhe nuk e ka përcjellë pranë Institucionit të Komisionerëve Publikë, ndryshe nga sa ka vepruar me vendimin përfundimtar nr. 802/2024, për konfirmimin në detyrë të subjektit të rivlerësimit.

10. Komisioneri Publik, paraprakisht, vendos në vëmendje vlerësimin e Kolegjit të Posaçëm të Apelimit, lidhur me format dhe qëllimin e dispozitave ligjore të njoftimit të vendimit të Komisionit, Komisionerëve Publikë, ku në jurisprudencën e tij[7], ndër të tjera, ka arsyetuar se: *[...] Në vlerësim të trupit gjykues, publikimi i vendimit në faqen zyrtare në internet të Komisionit nuk ka vlerë të*

[7] Referohuni jurisprudencës së Kolegjit në vendimin (JR) nr. 13/2021, prg. 35 i tij.

*<u>posaçme për efekt të njoftimit të subjektit të rivlerësimit dhe Komisionerit Publik, pasi është një mjet që nuk garanton në asnjë rast marrjen dijeni të tyre për publikimin e vendimit dhe aq më tepër nuk garanton njohjen me përmbajtjen e plotë të tij, qoftë edhe vetëm për faktin se të dhënat e pasqyruara në të janë të anonimizuara. Në rastin e Komisionerit Publik, vendimi duhet të jetë i shoqëruar edhe me dosjen e plotë të hetimit administrativ të zhvilluar nga Komisioni, në mënyrë që Komisioneri Publik të ushtrojë kompetencën kushtetuese të ushtrimit të ankimit ndaj vendimit të Komisionit, në mënyrë efektive, pas njohjes me aktet dhe provat e administruara nga ana e Komisionit, pasi nuk është palë procedurale në asnjë fazë të zhvillimit të hetimit dhe shqyrtimit të çështjes në Komision</u> [...].*

11. Në të tilla rrethana ligjore, me qëllim garantimin e mbrojtjes së interesit publik gjatë procesit të rivlerësimit, Komisioneri Publik ka detyrimin që të ushtrojë kontroll mbi vendimet e dhëna nga Komisioni, *duke vlerësuar nëse vendimmarrja e tij, në të cilën janë arsyetuar në mënyrë të plotë konkluzionet dhe qëndrimi i Komisionit për procesin e rivlerësimit të subjektit të rivlerësimit*, është në përputhje me kërkesat kushtetuese e ligjore, jurisprudencën e konsoliduar të Kolegjit, bazohet në një hetim administrativ të gjithanshëm e shterues dhe vlerësim të drejtë të provave.

12. Sa më sipër, Komisioneri Publik*, nga shqyrtimi i vendimit përfundimtar nr. 802, datë 23.9.2024,* së bashku me vendimin e ndërmjetëm nr. 4, datë 17.10.2023, të publikuar në faqen zyrtare të Komisionit, në zbatim të Rekomandimit të ONM-së të datës 16.10.2024, si dhe akteve bashkëlidhur çmon se ato përmbajnë shkaqe ligjore për t'u paraqitur për shqyrtim, nëpërmjet ankimit, juridiksionit kontrollues dhe rivlerësues të Kolegjit. Komisioneri Publik, bazuar në nenin C, pika 2, nenin F, pikat 3 dhe 7, të aneksit të Kushtetutës, si dhe në nenin 4 dhe 66, të ligjit nr. 84/2016, ushtron të drejtën e ankimit ndaj vendimit përfundimtar nr. 802/2024, të Komisionit për konfirmimin në detyrë të subjektit të rivlerësimit, në tërësinë e tij.

## IV. Analiza e shkaqeve të ankimit

### IV.A - Për vlerësimin e aftësive profesionale

13. Rezulton se Komisioni gjatë hetimit administrativ për procesin e rivlerësimit të subjektit të rivlerësimit, znj. Çela, lidhur me kriterin e aftësive profesionale, ka analizuar: (i) raportin e Këshillit të Lartë të Prokurorisë; (ii) të dhënat e administruara nga Prokuroria e Përgjithshme; (iii) denoncimet nga publiku dhe informacionet e aksesuara në media, si dhe (iv) dosjet penale të administruara për trajtimin e denoncimeve dhe ankesave.

14. Në datën **.9.2023,[8] përmes postës elektronike, trupi gjykues i Komisionit njoftoi subjektin e rivlerësimit mbi: (i) rezultatet e hetimit kryesisht; (ii) kalimin e barrës së provës sipas nenit 52 të ligjit nr. 84/2016 dhe të sjellë prova për të provuar të kundërtën; (iii) njohjen me provat e administruara nga Komisioni në përputhje me nenin 47 të ligjit nr. 84/2016 dhe nenet 45-47 dhe 35-40 të Kodit të Procedurave Administrative. Në këtë njoftim, subjektit iu kërkua të paraqiste edhe shpjegime brenda datës **.10.2023.

[8] Komisioni i Pavarur i Kualifikimit (në vijim Komisioni) ka hedhur shortin në datën 15.12.2020, nga i cili rezultoi se subjekti i rivlerësimit Flora Çela do t'i nënshtrohet procesit të rivlerësimit.

15. Komisioni, pasi i ka kaluar subjektit barrën e provës për sa ka konstatuar, ka administruar prapësimet e subjektit të rivlerësimit, në përfundim, ka arsyetuar se subjekti i rivlerësimit nuk arriti të provojë të kundërtën e barrës së provës, për 9 çështje/procedime penale, në të cilat Komisioni kishte evidentuar mangësitë profesionale në dosjet e verifikuara që lidheshin me: *(a) kërkesën për dërgimin e çështjes në gjykim; (b) vendime pushimi; (c) vendime mosfillimi të subjektit si prokuror i çështjes lidhur me vlerësimin profesional, sipas pikës 3, të nenit E, të aneksit të Kushtetutës dhe shkronjës "b", të nenit 44, të ligjit nr. 84/2016.*

15.1 Komisioni, në përfundim, ka vlerësuar *se subjekti shfaq mangësi në aspektin e njohurive ligjore bazuar në tregues të tillë si: aftësia e përgjithshme për të ndërmarrë logjikisht hetimin sipas kërkesave ligjore, për të mbledhur provat e kërkuara me ligj, për të interpretuar ligjin, si dhe në kriterin e aftësisë organizative për të kryer procedurat hetimore, kritere të parashikuara në pikën 2, të nenit 73 dhe në pikën 1, të nenit 74 të ligjit nr. 96/2016, "Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë", i ndryshuar.*

16. Në analizë të sa më sipër, Komisioneri Publik, në konsideratë edhe të Rekomandimit të ONM-së të datës 16.10.2024, konstaton se në rezultatet e hetimit administrativ, ndër të tjera, Komisioni, për mangësitë e konstatuara, i është referuar dhe informacioneve të marra nga aksesi në median e shkruar *online*[9], lidhur me lajmin mbi *një superoperacion policor në *** dhe ***, në Vlorë, në vitin 2017, ku u sekuestruan 20 tonë drogë dhe u arrestuan 9 persona si të dyshuar pjesëtar të një grupi trafikantësh*. Në shkrim thuhet se ata janë liruar vetëm dy ditë pas arrestimit.

16.1 Sipas shkrimit, në media thuhet se prokurorja Çela, tri ditë pas superoperacionit policor në *** dhe ***, është drejtuar me kërkesë për lirimin e shtetasve ***. ***. dhe ***. ***., duke kërkuar detyrimin e tyre për paraqitje në Policinë Gjyqësore dhe jo masën e arrestit në burg.

16.2 Për këtë çështje, Komisioni i kërkoi subjektit: *(i) të japë shpjegime të detajuara lidhur me ngjarjen e bërë publike; (ii) të sqarojë rrethanat e çështjes objekt hetimi; (iii) të sqarojë dhe dokumentojë kërkimin për masën e sigurimit personal për secilin shtetas, të sqarojë arsyet, faktet dhe rrethanat mbi të cilat është bazuar për të kërkuar masën e sigurimit personal detyrim paraqitje në Policinë Gjyqësore, në raport me rrezikshmërinë e veprës penale të publikuar dhe dënimin e parashikuar për të; (iv) të qartësojë nëse në vijim ka pasur kërkesa të tjera për zëvendësim të masës së sigurimit personal, dhe çfarë është vendosur për to, duke depozituar edhe çdo dokumentacionin mbështetës.*

16.3 Po ashtu, Komisioni i ka kërkuar subjektit: (i) të shpjegojë nëse kjo çështje është hetuar më tej nga ana saj. Në varësi të kësaj të fundit, Komisioni ka kërkuar: (ii) të qartësojë dhe dokumentojë veprimet hetimore të kryera, njoftimin e akuzës, kohën e zgjatjes së kryerjes së hetimeve, kërkimin gjyqësorit për themelin e çështjes, vendimmarrjen e organit gjyqësor, si dhe statusin aktual të çështjes, *duke mbështetur me dokumentacion (urdhra, vendime, procesverbale, kërkesa drejtuar gjykatës, diskutim/e përfundimtare, njoftim akuze, vendim/e gjyqësore etj.) të gjithë shpjegimet lidhur me këtë çështje, objekt hetimi*.

[9] https://***.**/u-kapen-20-tone-kanabis-ne-vlore-prokuroria-urdheron-lirimin-e-pronareve-te-droges.

16.4 Nga dokumentacioni i administruar, i sjellë nga vetë subjekti i rivlerësimit së bashku me prapësimet e saj, Komisioni ka konstatuar se rasti i referohet procedimit penal nr. ***, datë **.7.2017, regjistruar për veprat penale "*Prodhimi dhe shitja e narkotikëve", "Prodhimi dhe mbajtja pa leje e armëve luftarake dhe e municionit", si dhe "Pastrimi i produkteve të veprës penale ose veprimtarisë kriminale"*, të parashikuara nga nenet 283/2, 278 dhe 287 të Kodit Penal, ku sipas informacionit për referimin e veprës penale në Prokurori janë gjetur e sekuestruar në cilësinë e provës materiale 9166 kg e 600 g lëndë narkotike e llojit *cannabis sativa*, 112 kg e 500 g e llojit hashash, armë zjarri automatike kallashnikov, si dhe një arkë me fishekë.

16.5 Nga aktet e përcjella nga subjekti, ka rezultuar se subjekti për një pjesë të personave të arrestuar në kuadër të operacionit policor, të kapur në flagrancë, ka kërkuar masën e sigurimit "Arrest në burg", ndërsa me kërkesën datë **.7.2017, "Për vleftësimin e arrestit dhe caktimin e masës së sigurimit", për shtetasit ***. ***. dhe ***. ***., ka kërkuar masën e sigurimit "Detyrim për paraqitje", parashikuar nga neni 234 i Kodit Penal. Nga aktet e dosjes rezultoi se subjekti, në datën **.4.2019, *ka kërkuar pushimin e çështjes në ngarkim të shtetasve* ***., ***. dhe ***. ***. Rezultoi se subjekti i rivlerësimit, me qëllim hetimin pasuror të shtetasve ***. dhe ***. ***. dhe lidhjet me krimin në sigurimin e kësaj pasurie, ka vlerësuar të kryejë hetime për anëtarët e tjerë të familjes ***. në bankat e nivelit të dytë, Qendrën Kombëtare të Biznesit, autoritetet tatimore e doganore, ZVRPP-në, Drejtorinë e Përgjithshme të Shërbimit dhe Transportit Rrugor, ndërsa sipas akteve të administruara në fashikullin penal, nuk pasqyrohen të dhëna hetimore për anëtarin e familjes ***. ***., i dyshuar si organizator i kësaj veprimtarie të kundërligjshme, për të cilin gjithashtu është kërkuar pushimi i procedimit.

16.6 Komisioni ka arsyetuar që duket se subjekti i rivlerësimit, në vlerësimin e kërkesës për pushimin e çështjes edhe për shtetasin ***. ***., është mjaftuar vetëm me hetimin lidhur me transkriptimet e përgjimeve telefonike dhe gjurmët papilare të këtij shtetasi. Në përfundim, në analizë të akteve në dosje, në raport me qëndrimin e subjektit dhe ligjin e zbatueshëm, pavarësisht vendimmarrjes përfundimtare, konstatohet se subjekti i rivlerësimit nuk ka kryer veprimet e nevojshme dhe të plota hetimore në drejtim të qartësimit të çdo rrethane dyshuese të dalë nga hetimi.

16.7 Komisioni, edhe për këtë rast, ka vlerësuar se subjekti shfaq mangësi në aspektin e njohurive ligjore bazuar në tregues të tillë si: aftësia e përgjithshme për të ndërmarrë logjikisht hetimin sipas kërkesave ligjore, për të mbledhur provat e kërkuara me ligj, për të interpretuar ligjin, si dhe në kriterin e aftësisë organizative për të kryer procedurat hetimore, kritere të parashikuara në pikën 2, të nenit 73 dhe në pikën 1, të nenit 74, të ligjit nr. 96/2016, "Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë", i ndryshuar.

17. Komisioneri Publik, në zbatim të Rekomandimit të ONM-së të datës 16.10.2024, në analizë të akteve në dosje, rezultateve të hetimit, si dhe prapësimeve të subjektit të rivlerësimit, bazuar në vendimin e Gjykatës Kushtetuese nr. 2, datë 18.1.2017[10], si dhe jurisprudencën e Kolegjit, ndan

[10] Në vendimin e Gjykatës Kushtetuese nr. 2/2017, në paragrafin 54 të tij, ndër të tjera, citohet se në lidhje me kriteret dhe standardet për kryerjen e kontrollit të aftësive profesionale, gjykata vlerëson të theksojë se:... Është shumë e rëndësishme që vlerësimi negativ të bëhet vetëm në rastet e gabimeve thelbësore dhe serioze dhe/ose kur ekziston një seri e qartë dhe e vazhdueshme e gjykimeve të gabuara, që tregojnë mungesë të aftësive profesionale (shihni edhe opinionin CDL-AD (2016)036 të Komisionit të Venecias).

qëndrim të ndryshëm nga Komisioni dhe çmon se kontrolli i aftësisë profesionale për subjektin e rivlerësimit nuk e ka kaluar nivelin kualifikues për konfirmimin e saj në detyrë dhe se subjekti i rivlerësimit me veprimet/mosveprimet e saj ka rezultuar e papërshtatshme nga vlerësimi i aftësive profesionale, si dhe ka cenuar besimin e publikut në sistemin e drejtësisë, duke u gjendur në kushtet që mangësitë e evidentuara, nuk mund të plotësohen as nga programi i trajnimit në Shkollën e Magjistraturës.

17.1 Ndryshe nga sa ka arsyetuar Komisioni në vendimin e ndërmjetëm nr. 4/2023 dhe, më pas, në vendimin përfundimtar nr. 802/2024, Komisioneri Publik, lidhur me vlerësimin e kriterit të aftësive profesionale arrin në konkluzionin se, në rastet kur gabimet e subjekteve të rivlerësimit evidentohen që përsëriten në mënyrë të vazhdueshme dhe në praktika të ndryshme, përbëjnë përjashtim nga rastet e konfirmimit në detyrë dhe duhet të vlerësohen negativisht. Komisioneri Publik çmon se subjekti i rivlerësimit nuk ka dhënë shpjegime bindëse mbi gjetjet në vlerësimin e aftësive profesionale, si dhe nuk ka arritur të provojë të kundërtën e barrës së provës, gjetje të cilat, përveç sa trajtuar gjerësisht në rezultatet e hetimit dhe dy vendimet e Komisionit, për të cilat subjekti nuk provoi të kundërtën e barrës së provës, duhet të merren në shqyrtim nga ana e Kolegjit, edhe për sa në vijim:

18. ***Lidhur me procedimin penal, nr. ***, datë **.7.2017, regjistruar për veprën penale të "Prodhimi dhe shitja e narkotikëve", "Mbajtje pa leje dhe prodhimi i armëve shpërthyese dhe e municionit", si dhe "Pastrimi i produkteve të veprës penale ose veprimtarisë kriminale", parashikuar nga neni 283/2, 278 dhe 287 i Kodit Penal***

18.1 Komisioneri Publik, lidhur me procedimin penal nr. ***/2017, në zbatim dhe të Rekomandimit të ONM-së të datës 16.10.2024, për sa trajtuar dhe më sipër në shkaqet e ankimit, konstaton se vendimmarrja e Komisionit lidhur në këtë rast, i referohet akteve të sjella nga vetë subjekti i rivlerësimit në funksion të barrës së provës, në prapësimet e saj të datës **.10.2023. Ndërkohë ONM, bazuar në nenin B, germa "ç" e aneksit të Kushtetutës, ka administruar të plotë aktet e dosjes së Prokurorisë dhe Gjykatës, lidhur me çështjen, akte të cilat janë aksesuar dhe nga Komisioneri Publik.

18.2 Prokuroria pranë Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm, Vlorë, në përgjigje të kërkesës së vëzhguesit ndërkombëtar, me shkresën nr. ***/* prot., datë **.1.2024 (protokolluar në ONM më datë **.1.2024, me nr. ***/* prot.), ka përcjellë, ndër të tjera, fotokopje të njësuar me origjinalin të akteve të procedimit penal nr. ***/2017.

18.3 Gjykata e Shkallës së Parë e Juridiksionit të Përgjithshëm, Vlorë, në përgjigje të kërkesës së vëzhguesit ndërkombëtar, me shkresën nr.***/* prot., datë **.1.2024 (protokolluar në ONM më datë **.1.2024, me nr. ***/* prot. ex), ka përcjellë, ndër të tjera, kopje të dosjes penale që i përket vendimit nr. ***, datë **.7.2019, Gjykata e Shkallës së Parë e Juridiksionit të Përgjithshëm Vlorë, me të pandehur ***. ***., ***. ***. dhe ***. ***.

18.4 Nga aktet e administruara ka rezultuar se Drejtoria e Policisë Vlorë, Seksioni Kundër Lëndëve Narkotike dhe Trafiqeve të Paligjshme, më datë **.7.2017, ka marrë informacion mbi një sasi të konsiderueshme të lëndëve narkotike të llojit *cannabis sativa*, të ndodhur në fshatin ***, Vlorë. Pas një operacioni të organizuar, policia, ndër të tjera, ka sekuestruar armë tip Kallashnikov

dhe rreth 15,6 tonë *cannabis sativa*, të paketuara dhe gati për ngarkesë, si dhe bimë kanabisi të mbjella. Janë arrestuar 9 persona, nga të cilët oficerë policie dhe zyrtarë të zonës.

18.5 Më datë **.7.2017, Prokuroria pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor, Vlorë, mbi bazën e materialit të referuar nga Drejtoria e Policisë Vendore Vlorë, ka regjistruar procedimin penal nr. ***/2017, për veprat penale "Prodhimi dhe shitja e narkotikëve", "Mbajtje pa leje dhe prodhimi i armëve shpërthyese dhe e municionit", parashikuar nga neni 283/2, 278/1 i Kodit Penal.

18.6 Nga informacionet e disponuara ka rezultuar se persona të dyshuar për këtë vepër penale janë shtetasit ***. ***., ***. ***. dhe ***.***., familjarë mes tyre, të cilët dyshohen se në bashkëpunim edhe me persona të tjerë, kanë grumbulluar me qëllim shitjen më tej të lëndës narkotike. Referuar sasisë së madhe të konstatuar në vendin e ngjarjes, është e dukshme që kjo vepër është kryer në bashkëpunim edhe me persona të tjerë, ku secili prej tyre ka pasur role të mirëpërcaktuara në gjetjen, grumbullimin, ruajtjen dhe më tej hedhjen në treg të lëndës narkotike. Shtetasit ***. ***. dhe ***. ***. janë arrestuar në flagrancë, ndërsa shtetasi ***. ***. nuk është gjetur në vendin e ngjarjes dhe as në vendin e tij të punës, *** *Kafe Restorant*, në Vlorë. Ky procedim është trajtuar nga subjekti i rivlerësimit.

18.7 Nga aktet rezulton se Drejtoria Vendore e Policisë Vlorë, më datë ** Shtator 2017[11], ka referuar pranë organit të Prokurorisë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë, Vlorë, materialin për *fillimin e procedimit pasuror* ndaj shtetasve ***. ***. dhe ***. ***., si dhe familjarëve të tyre (ndër to dhe shtetasin ***. ***.), për të cilët janë identifikuar pasuri, të cilat nuk justifikohen nga pikëpamja ekonomike dhe dyshohet se janë përfituar nga shtetasit e lartpërmendur, përfshirë këtu dhe Bar-Kafe Restorant *"***"*. Në këtë material referohet se në ngarkim të shtetasit ***. ***. janë regjistruar të dhëna kriminale në fushën e trafikimit të lëndëve narkotike prej vitit 2015, ndërsa për shtetasin ***. ***. rezultojnë të dhëna të regjistruara në fushën e trafikimit të lëndëve narkotike, që prej vitit 1999.

18.8 Në rrethana të ngjashme me shtetasit ***., ***. dhe ***. ***., si një tregues i mëtejshëm i përmasave të këtij aktiviteti, rezulton se në vijim të kontrolleve të ushtruara në këtë zonë, në një ndërtesë të braktisur, janë gjetur dhe rreth 5 tonë të tjera *cannabis sativa*, hetimi për të cilat është bërë në një procedim të ndarë nga procedimi nr. ***/2017, rrethana të cilat i ka përshkruar dhe subjekti i rivlerësimit në prapësimet e saj, ku ndër të tjera, është shprehur se: *[...] Pas këqyrjes së kësaj banese, nga ana e grupit hetimor ka vazhduar kontrolli i mëtejshëm në këtë fshat, duke u kapur në flagrancë në banesën e tij shtetasi ***. ***., me një sasi lëndë narkotike, për të cilën ka pasur edhe mjet përpunues për vaj hashashi... Gjithashtu ky shtetas është gjetur në vendin e ngjarjes [...]*. Referuar informacioneve mediatike[12], duket se shtetasi ***. ***. është lënë në gjendje të lirë nga Gjykata e Shkallës së Parë, Vlorë, vendim i cili është ndryshuar nga Gjykata e Apelit Vlorë, e cila e ka rikthyer në burg, por ekzekutimi nuk është bërë i mundur, pasi shtetasi ***. ***. nuk është gjendur në banesë.

[11] Referimi për materialin mban datën **.9.2017, ndërsa shkresa përcjellëse mban datën **.10.2017, me nr.*** prot.

[12] https://***.com.al/aktualitet/gjykata-e-vlores-rikthen-ne-burg-poseduesin-e-droges-ne-***-autori-arratiset/Në media *online*, mund t'iu referoheni dhe artikujve të tjerë.

18.9 Drejtoria Vendore e Policisë Vlorë, tri ditë pas regjistrimit të procedimit penal nr. ***/2017, me shkresën nr. ***, datë **.7.2017, ka dërguar në Prokurorinë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Vlorë, materiale procedurale lidhur me referimin e veprës penale të "Prodhimit dhe shitjes të bimëve narkotike", parashikuar nga neni 283/1 i K. Penal, ku ndër të tjera, përshkruhet se: *[...] Gjatë kontrollit të mëtejshëm të këtij territori është konstatuar se nga ana lindore e përroit, ku ndodhet parcela me ullinj e shtetasit ***.***.... dhe në afërsi të koshereve të bletëve që ndodheshin brenda kësaj bahçe, u konstatua një thes i zi, brenda të cilit kishte shtatë qese plastmasi... Nga peshimi i bërë lëndës narkotike gjetur te kosheret e bletëve, si dhe në anë të gardhit, u konstatua një peshë prej 26 kg e 400 g. Më pas vazhdoi kontrolli në përrua, ku u konstatuan dyzet e tre qese plastmasi me ngjyrë të zezë... me peshë 670 kg e 300 g... Shtetasi ***. ***. deklaroi se...toka matanë përroit është e shtetasit ***. ***., në lidhje me bletët kam kohë pa vajtur andej dhe nuk kam dijeni të kujt janë [...].* Subjekti i rivlerësimit duket se ka regjistruar në vijim procedimin penal nr. ***/2017.

18.10 Nga aktet, rezulton se subjekti në datën **.4.2019, në përfundim të hetimit të procedimit penal nr. ***, të filluar më datë **.7.2017, ka drejtuar pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Vlorë, kërkesën për pushimin e çështjes në ngarkim të shtetasve ***., ***. dhe ***. ***. Gjykata e Rrethit Gjyqësor Vlorë, me vendimin nr. ***, datë **.7.2019, ka vendosur: *[…] Pushimin e procedimit penal nr. *** të vitit 2017, të regjistruar për veprën penale të "Prodhimi dhe shitja e narkotikëve", parashikuar nga neni 283/2 i K. Penal, "Prodhimi dhe mbajtja pa leje e armëve, armëve shpërthyese dhe e municionit", parashikuar nga neni 278 i K. Penal dhe "Pastrimi i produkteve të veprës penale ose veprimtarisë kriminale", parashikuar nga neni 278 i K. Penal […].* Referuar shënimit të sekretarisë, ky vendim ka marrë formë të prerë, më datë **.7.2019, pasi nuk u ankimua.

18.11 Po ashtu, nga aktet duket se subjekti i rivlerësimit, në përfundim të hetimit të procedimit penal nr.***, të vitit 2017, ka paraqitur pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Vlorë, në datën **.8.2018, kërkesën penale me objekt *"Gjykimin e procedimit penal nr.***/2017, në ngarkim të shtetasve ***. ***.; ***. ***.; ***. ***.; dhe ***. ***, të akuzuar për kryerjen e veprave penale të "Kultivimit të bimëve narkotike", në bashkëpunim dhe "Shpërdorimit të detyrës", parashikuar nga nenet 284/2 dhe 248 të K. Penal"*. Pas gjykimit në dy shkallët e gjyqësorit, vetëm njëri nga këta shtetas, shtetasi ***. ***., është shpallur fajtor për veprën penale të "*Kultivimit të bimëve narkotike"*, parashikuar nga neni 284/1 i K. Penal. Gjykata e Apelit Vlorë, me vendimin nr. **, datë **.3.2019, në bazë të nenit 406 të K. Pr. Penale, e ka dënuar këtë shtetas përfundimisht me 2 vjet dhe 8 muaj burgim, nga 4 vite të caktuara.

19. Komisioneri Publik, në zbatim dhe të Rekomandimit të ONM-së të datës 16.10.2024, në dritën e këtyre rrethanave, çmon se për vlerësimin e aftësive profesionale të subjektit të rivlerësimit, znj. Çela, është e nevojshme që Kolegji i Posaçëm i Apelimit të shqyrtojë aktet e procedimit penal nr. ***/2017 dhe nr. ***/2017, të administruara për këtë rast nga ONM, dhe së bashku dhe me gjetjet e tjera në kriterin e aftësive profesionale të subjektit të rivlerësimit, të konstatuara dhe nga Komisioni, të rivlerësojë sjelljen profesionale të znj. Çela dhe modelin e saj të punës.

20. Komisioneri Publik, në zbatim dhe të Rekomandimit të ONM-së të datës 16.10.2024, përveç sa rezulton nga përmbajtja e vendimit përfundimtar nr. 802/2024 të Komisionit, për të cilat subjekti i rivlerësimit nuk arriti të provonte të kundërtën e barrës së provës, vlerëson se vendimmarrja dhe veprimet e subjektit të rivlerësimit tregojnë një model pune të dobët dhe jo profesional të subjektit të rivlerësimit, për sa do trajtohet në vijim:

20.1 Trajtimi i rastit nga subjekti i rivlerësimit, për veprën penale *"Kultivimi i bimëve narkotike"*, të parashikuar nga neni 284 i K. Penal, më së paku, nxjerr në pah mangësi dhe hetim të dobët të kryer nga subjekti i rivlerësimit, i cili ka bërë të pamundur zbardhjen e plotë të mekanizmit të ngjarjes dhe rolit dhe përgjegjësisë së secilit pjesëmarrës në të, situatë faktike e cila vë në dyshim serioz thelbin e vendimmarrjes së prokurores për akuzat e personave të përfshirë në procedimin penal, duke afektuar në këtë mënyrë indikatorin e parashikuar nga neni 73, pika 2 e ligjit nr. 96/2016.

20.2 Rrethanat e ngjarjes, të dokumentuara nga aktet në dosje, lidhur me: (1) informacionet e qëndrueshme dhe veprimet operacionale të organeve ligjzbatuese; (2) sasinë e konsiderueshme të lëndëve narkotike të sekuestruara; (3) faktin që lëndët narkotike ishin të paketuara dhe gati për transport; (4) rrezikshmërinë dhe sasinë e armëve të konfiskuara; si dhe (5) faktit që mes të dyshuarve kishte dhe zyrtarë me funksione publike (prania e një zyrtari të fshatit dhe oficerëve të policisë ndër të arrestuarit), janë tregues që rasti duhej trajtuar sipas nenit *283/a, "Trafikimi i narkotikëve"* dhe nenit 284/a, "*Organizimi dhe drejtimi i organizatave kriminale*", të Kodit penal. Komisioneri Publik, në konsideratë të Rekomandimit të ONM-së, vlerëson se në këto rrethana nuk duket se çështja penale bënte fjalë për kultivim apo mbajtje për përdorim personal, por duket se përmbante elemente të një operacioni të madh të trafikimit të organizuar të lëndëve narkotike, në të cilin duket se askush nuk u shpall përgjegjës për rreth 16 tonë kanabis të paketuara dhe për armët e sekuestruara.

20.3 Subjekti i rivlerësimit nuk e transferoi rastin për kompetencë në Prokurorinë e Krimeve të Rënda. Gjatë seancës dëgjimore në Komision, subjekti i rivlerësimit, i pyetur nga Vëzhguesi Ndërkombëtar, për të shpjeguar mbi arsyet e mostransferimit të rastit në këtë Prokurori, ndër të tjera, *deklaroi se ishte periudha që Prokuroria për Krimet e Rënda ishte duke u mbyllur, dhe materialet ishin duke u dërguar në prokuroritë e rretheve dhe ndodhen dhe ndryshimet e K. Procedurës Penale 2017.*

20.4 Komisioneri Publik, në zbatim dhe të Rekomandimit të ONM-së të datës 16.10.2024, vlerëson se shpjegimet e subjektit dhe në këtë rast, nuk janë bindëse[13], dhe mbetet e paqartë pse një ndër veprimet operacionale më të mëdha antikanabis që është ndërmarrë në Shqipëri, u nda në procedime të veçanta, duke e zbehur kështu rëndësinë e rastit dhe kurrë nuk u referua në zyrën e Prokurorisë kompetente, e cila në atë kohë ishte Prokuroria për Krime të Rënda. Në këto rrethana, duket se subjekti i rivlerësimit, më së paku, ka vepruar me një neglizhencë të dukshme e me një qasje gati të paracaktuar drejt mostrajtimit të rastit si krim i kryer nga një organizatë e strukturuar

[13] ONM, në Rekomandim, referon se vetëm 3 muaj para sekuestrimit të 16 tonëve në këtë rast, një zyrë tjetër prokurorie, në Përmet, i referoi zyrës së Prokurorisë për krime të rënda një rasti, në të cilin u sekuestruan 12 tonë *kanabis sativa,* në rrethana shumë të ngjashme.

kriminale, rast i cili ishte plotësisht brenda juridiksionit të Gjykatës për Krimin e Organizuar dhe Korrupsionin, ndërkohë që Prokuroria e Krimeve të Rënda ka ushtruar aktivitetin dhe për dy vite të tjera, dhe ndryshimet e Kodit ë Procedurës Penale ishin pa ndikim në këtë proces.

20.5 Po ashtu nga aktet rezulton, se nga oficeri i Policisë Gjyqësore, në kuadër të veprimeve të para hetimore, *më ** korrik 2017*, gjatë kontrollit në restorantin "Bar ***", në pronësi të shtetasit ***. ***., *** ***, Vlorë, ishte sekuestruar një pajisje elektronike DVR, e ambientit të lokalit, material i cili mund të kishte siguruar të dhëna mbi kontaktet e personave të përfshirë. Përmbajtja e DVR-së rezulton se u ekzaminua më datë *** qershor 2018*, pothuajse një vit pas sekuestrimit, ku referuar procesverbalit të këqyrjes, rezulton se: *[...] lidhet aparati me ushqyesin e saj dhe lidhet me energjinë elektrike. Pasi shtypet butoni i ndezjes së aparatit vërehet se aparati nuk ndizet. Gjë tjetër me interes nga këqyrja nuk rezultoi [...].*

20.6 Nga aktet në dosje, nuk duket që subjekti i rivlerësimit të ketë ndërmarrë hapa procedurale apo të ketë hartuar akte në të cilat të delegojë detyra hetimore Policisë Gjyqësore, në kundërshtim me nenin 294/b, "Infiltrimi në përbërje të grupit kriminal" apo neni 304, "Veprimtaria hetimore e prokurorit". Dosja përmban vetëm procesverbalin e datës ** gusht 2018, në të cilin referohen disa informacione mbi veprime bazike hetimore, si: pyetja e personave që kanë dijeni për veprën penale, dërgimi në laborator i mostrave për të marrë shenjat e gishtave në paketat e bimëve narkotike dhe administrimi i disa fotove nga vendi i ngjarjes. Dokumentacioni në dosje duket shumë i vakët në raport me rrethanat e çështjes, nga ku rezultoi i dënuar vetëm një person me një dënim minimal, për sa më sipër trajtuar.

20.7 Masa e sigurisë e kërkuar nga subjekti i rivlerësimit, për të dyshuarit "*Detyrimi për t'u paraqitur në Policinë Gjyqësore"*, nisur nga rrethanat e ngjarjes, duket tërësisht e papërshtatshme, veçanërisht duke pasur në konsideratë se për një nga të dyshuarit, shtetasin ***. ***., rezultonin të dhëna të regjistruara në fushën e trafikimit të lëndëve narkotike, që prej vitit 1999. Vetë Gjykata e Rrethit Gjyqësor, Vlorë, në vendimet lidhur me caktimin e masave të sigurisë, ndër të tjera, ka arsyetuar se: *[...] Gjykata arrin në konkluzionin se e vetmja masë efektivisht e aftë për të siguruar normalitetin e vazhdimësisë së hetimit dhe gjykimit eventualisht të çështjes është ajo e "Arrest në burg", parashikuar nga neni 238 i K. P. P., duke u përjashtuar çdo masë tjetër sigurimi më e butë. Pavarësisht sa më sipër, Prokuroria ka parashtruar kërkesën që ndaj shtetasit nën hetim ***. ***., të caktohet masa e sigurimit personal "Detyrim paraqitje në Policinë Gjyqësore", parashikuar nga neni 234 i K. P. P. Gjykata vlerëson se kjo masë nuk është e përshtatshme. Në nenin 244/3 i K. P. P, parashikohet ky ndalim ligjor: "Gjykata nuk mund të caktojë një masë sigurimi më të rëndë sesa ajo e kërkuar nga prokurori" [...].*

20.8 Nga aktet duket se, pavarësisht se Drejtoria e Përgjithshme e Policisë së Shtetit, më ** dhjetor 2017, ka përcjellë *një analizë të dhënave për llogari të hetimit telefonik në lidhje me procedimin penal nr. ***, i vitit 2017*, të administruara nga kompanitë celulare, nga organi i Prokurorisë, nuk duket të jenë bërë përpjeke për të kontaktuar personat mbartës të këtyre numrave të telefonit, për të marrë dëshmitë e tyre.

20.9 Referuar procesverbalit për pyetjen e personit ndaj të cilit zhvillohen hetime, rezulton se subjekti i rivlerësimit ka marrë në pyetje shtetasin ***. ***., vetëm më datë ** prill 2019, pothuajse

dy vite nga sekuestrimi i bimëve narkotike, pas arrestit në flagrancë. Në dosje nuk duket të jetë dokumentuar "*Ftesa për paraqitje*", ndaj shtetasit ***. ***., në kundërshtim me parashikimet e nenit 308 të K. Procedurës Penale.

20.10 Nga aktet në dosje të procedimit penal, nuk duken të jenë ndërmarrë hapa hetimorë në drejtim të përgjegjësisë së shtetasit ***. ***., pavarësisht faktit se ky shtetas ishte formalisht i regjistruar si i dyshuar për veprën penale. Në anën tjetër, duket se ky shtetas ka qenë në dijeni të ecurisë së procedimit penal, për sa kohë emri i tij ndodhet në dokumentet, të cilat e kanë njoftuar atë. Po ashtu rezulton se ky shtetas nuk është hetuar lidhur me asetet e tij financiare, pavarësisht informacioneve dhe lidhjes që kishte si anëtarë i familjes ***.

20.11 Pavarësisht informacioneve, lidhur me mosjustifikimin e pasurive të personave të përfshirë, nuk duket të jenë ndërmarrë veprime të tjera hetimore në drejtim të përcaktimit të mundësisë financiare të të gjithë pjesëtarëve të familjes ***., për të krijuar pasuritë e tyre, në kundërshtim me ligjin nr. 10192, datë 3.12.2009, *"Për parandalimin dhe goditjen e krimit të organizuar, trafikimit dhe korrupsionit nëpërmjet masave parandaluese kundër pasurisë"*, duke përjashtuar nga analiza financiare shtetasin ***. ***., shtetas i cili ishte i regjistruar si person nën hetim për veprat penale të *"Prodhimi dhe shitja e narkotikëve"* dhe *"Pastrimi i produkteve të veprës penale ose veprimtarisë kriminale".*

20.12 Nga aktet në dosje, nuk duket të jenë ballafaquar shenjat e gishtave në qeset ku u sekuestruan 10 tonë bimë narkotike, me shenjat e gishtave në bazën e të dhënave të Policisë së Shtetit, për të kuptuar se kujt i përkisnin ato. Në dosje gjendet i administruar një *vendim për kryerjen e ekspertimit daktiloskopik dhe për të përcaktuar nëse në sipërfaqen e qeseve brenda të cilave ndodhet lënda narkotike a konstatohen gjurmë papilare*, që daton më ** *qershor 2018*, rreth një vit më vonë nga data e sekuestrimit.

20.13 Nga aktet në dosje nuk duket se është kryer ndonjë veprim hetimor lidhur me përcaktimin e pronësisë së koshereve të bletëve, që ndodheshin shumë afër me tokën ku u sekuestrua bima narkotike, për të cilën banorët e zonës dëshmonin se është në pronësi të shtetasit ***. ***. Rezulton se janë marrë dëshmi të banorëve të zonës rreth shtëpisë ku policia sekuestroi bimët narkotike, por këto dëshmi janë marrë në korrik të vitit 2018, sërish rreth 1 vit pas veprimeve operacionale të policisë. Po ashtu, rezulton se Prokuroria, vetëm më datë ** korrik 2018, i është drejtuar me kërkesë Drejtorisë së Administrimit dhe Mbrojtjes Tokës, Vlorë, për marrjen e informacionin mbi parcelat e tokës në pronësi të shtetasit ***. ***.

